



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.10 Regj.Them.**  
**Datë Rregj. 11.04.2023**

**Nr.10 VENDIMI**  
**Datë 18.04.2023**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtare: Alma KOLGJOKA** (*Relatore*)  
**Gjyqtare: Edlira PETRI** (*Anëtare*)  
**Gjyqtare: Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)  
**Gjyqtare: Emona Muçi** (*Anëtare*)  
**Gjyqtare: Marsela DERVISHI** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë 18.04.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.10 Akti, datë 11.04.2023 që i përket:

**PADITËS:** **Eduard Nallbani**, në cilësinë e Kandidatit për Anëtar të Këshillit të Bashkisë, Bashkia Tiranë.

**IPADITUR:** **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar nga Ina Osmanaj dhe/ose Erdal Mema, pajisur me Autorizim nr. 3878 Prot. datë 17.04.2023.

**OBJEKTI:**

Gjykimin e çështjes në themel duke:

1. Rrëzuar Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.220 datë 30.03.2023
2. Rrëzuar Vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. (Nuk është publikuar ende) datë 04.04.2023.
3. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat për *ANËTAR TË KËSHILLIT BASHKIAK* i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 45 i Kushtetutës së RSH, nenet 70, 145 e vijues të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"(i ndryshuar).

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku:

**Pala paditëse, Eduard Nallbani** kërkoi:

- Pranimin e padisë sipas objektit;

**Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** kërkoi:

- Rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.44 datë 04.04.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.43 datë 01.04.2023, të depozituar nga z.Eduard Nallbani", të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve;

**VËREN:**

**1.** Se pala paditëse, Eduard Nallbani i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “Gjykimin e

*çështjes në themel duke: rrëzuar Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 220, datë 30.03.2023; rrëzuar Vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. (Nuk është publikuar ende) datë 04.04.2023; detyrimin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimi e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat për ANËTAR TË KËSHILLIT BASHKIAK i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.*

## **I. FAKTET E ÇËSHTJES:**

**2.** Pala paditëse/subjekti Eduard Muhamet Nallbani ka nënshkruar deklaratën për pranimin e kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë.

**2.1** Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, ka autoritetin dhe përgjegjësinë e nxjerrjes së akteve nënligjore për rregullat për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe afatet për zbatimin tyre në përputhje me Kodin Zgjedhor.

**3.** Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.13864 datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Për të qenë pjesë e këtyre zgjedhjeve, subjekti Eduard Nallbani ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit. Kështu ka rezultuar e provuar se me vendimin nr.145 datë 08.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen si Anëtar të Këshillit Bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Për këtë arsye, Komiteti Nismëtar më datë 24 mars 2023, ka regjistruar pranë KQZ-së kërkesën për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, si kandidat për Anëtar të Këshillit Bashkiak, duke depozituar edhe aktet e mëposhtme, në respektim të

kërkesave të ligjit: a- Formulari për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01; b- Kërkesën për regjistrimin e Komitetit Nismëtar Model KQZ-04-04; c- Kërkesën për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Model KQZ-04-05; d- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme Model KQZ-04-08; e- Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09; f- Jetëshkrimi i kandidatit Model KQZ-04-10; g- Formular i vetëdeklarimit; h- Dokumentin identifikues për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak; i- Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit.

**4.** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.220 datë 31.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur,

*1. Mosregjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*

*2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

*3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.*

**5.** Kundër këtij vendimi pala paditëse/subjekti Eduard Nallbani”, ka paraqitur ankesë më datë 01.04.2023 ora 19:40 (*sipas protokollimit pranë KQZ me nr. 2831 prot., datë 01.04.2023*) në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt: “Për ndryshimin e vendimit nr. 220, datë 30 mars 2023, duke vendosur regjistrimin e z.Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat për Anëtar të Këshillit Bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 04.04.2023, ora 12:00. Kërkesa ankimore iu paraqit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili pas shqyrtimit dhe administrimit të: Kërkesës ankimore nr.43 datë 01.04.2023; Vendimit nr.220

datë 30.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, me vendim nr. 44, datë 04.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 43, datë 01.04.2023 të depozituar nga z. Eduard Nallbani” Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ka vendosur:

*1. Rrëzimin e Ankimit*

*2. Lënien në fuqi të vendimit nr.220 të datës 31 Mars 2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

*3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.*

*4. Kundër këtij vendimi mund lejohet të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 ditëve.*

**7.** Subjekti Eduard Nallbani, pasi është bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

**8. Pala paditëse,** subjekti Eduard Nallbani në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, pretendoi se:

- Komiteti Nismëtar (Vendimi 145 KSHZ), si edhe paditësi/subjekti Eduard Muhamet Nallbani kanë nënshkruar kërkesat dhe deklaratën për pranimin e kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore te datës 14/maj/2023, për kandidat për Anëtar në Këshillin Bashkiak, Bashkia Tiranë, duke korigjuar terminologjinëe përdorur “jo për kandidad për kryetar të Bashkisë” referuar paragrafit të fundit të pikës 3, të nenit 70 të Kodit, siç është arsyetuar në vendimin 220/2023 të Komisionerit, pasi paragrafi i cituar në arsyetim nuk është për Kandidat për Anëtar të Këshillit Bashkiak.
- Në seancën publike të datës 04.04.2023 në KAS u mor në shqyrtim kërkesa ankimore 43, përfaqësuesi i Komisionerit në arsyetimin e tij për të mbrojtur vendimin e Komisionerit nr.220/2023, ka cituar një nen tjetër, nenin 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor (duke pranuar kështu që vendimi nr.220/2023 është

arsyetuar dhe ose është bërë gabim në referim të "nenit 70"). Por edhe ky nen është i gabuar sepse është për 'Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve'.

- Në këto kushte dokumentet e kandidimit për *Anëtar në Këshillin Bashkiak*, për Bashkinë Tiranë, plotësojnë kushtet e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka kusht për numër zgjedhësish për të mbështetur për anëtar të këshillit bashkiak, mjafton formulari për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ- 04-01, si kur të ishte i nënshkruar edhe nga 1 (një) zgjedhës.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë vendim duke regjistruar Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat për Anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë.
- Përsa më sipër, paditësi Eduard Nallbani kërkoi "Pranimin e padisë Gjykimin e çështjes në themel duke: Rrëzuar Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.220 datë 30.03.2023. Rrëzuar Vendimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. 44 datë 04.04.2023. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat për *ANËTAR TË KËSHILLIT BASHKIAK* i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

**9. Pala e paditur,** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimin prapësoi se:

- Komiteti Nismëtar që është angazhuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për z. Eduard Nallbani, është regjistruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.145 datë 08.03.2023.
- Bazuar në përmbajtjen e nenit 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor, referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve, rezulton se zona zgjedhore Bashkia Tiranë ka 699 748 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) zgjedhës. Rrjedhimisht, numri i zgjedhësve që do të duhej të nënshkruanin në mbështetje të kandidimit të ankuesit në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, duhet të ishte 7 000 (shtatë mijë) zgjedhës.

- Rezulton se komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet e 109 (njëqind e nëntë) zgjedhësve në mbështetje të kandidimit të paditësit Nallbani.
- Në pikën 4 të nenit 70, renditen qartësisht rastet në të cilët kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, përfshirë ata për këshillat vendorë, përjashtohen nga detyrimi i mbështetjes nga 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore (parashikuar në pikën 3). Këto raste janë: - nëse janë kryetarë bashkie; - nëse janë anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse; - nëse janë deputetë. Në këtë rast kandidati duhet të paraqesë një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit. Përsa kohë ankimesi nuk rezulton të përfshihet në asnjërën nga kategoritë e cituara më sipër, ai kishte detyrimin që komiteti nismëtar për mbështetjen e kandidimit të z. Nallbani, të paraqiste në KQZ nënshkrimet mbështetëse të të paktën 7000 (shtatë mijë) zgjedhësve të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë.
  - Përfundimisht, kërkohet rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit nr.44 datë 04.04.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.43 datë 01.04.2023, të depozituar nga z. Eduard Nallbani", të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

**10.** Kolegji pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoji pretendimet e palëve, vlerëson se padia me paditës Eduard Nallbani duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në prova dhe në ligj.

### **Neni 70**

Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012 datë 19.7.2012)

1. *Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë ose një kandidat për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.*
2. *Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë 36 partie apo koalicioni që konkurron në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron*

në atë zonë zgjedhore.

3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

**11.** Kodi Zgjedhor parashikon mundësinë e individëve që zgjedhin të garojnë si kandidatë të pavarur për kryetar bashkie ose kandidat për këshillin vendor në zgjedhjet e përgjithshme vendore, të cilët duhet të kalojnë fillimisht procedurën e regjistrimit të një komiteti nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse dhe ky komitet më pas duhet të mbledhë firma mbështetëse për kandidatin. Kolegji konstatoi nga provat e paraqitura nga palët se me vendimin nr.145 datë 8.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e z. Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Me shkresën nr.1903 Prot. datë 24.3.2023, komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet mbështetëse të 109 (njëqind e nëntë) zgjedhësve.

**12.** Bazuar në përmbajtjen e nenit 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor, referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve, rezulton se zona zgjedhore Bashkia Tiranë ka 699 748 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) zgjedhës. Rrjedhimisht, numri i zgjedhësve që do të duhej të nënshkruanin në mbështetje të kandidimit të ankuesit në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, që i



korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, duhet të ishte 7 000 (shtatë mijë) zgjedhës. Rezulton se komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet e vetëm 109 (njëqind e nëntë) zgjedhësve në mbështetje të kandidimit të paditësit Nallbani, duke mos përmbushur kështu kushtin e parashikuar në këtë nen.

**13.** Referuar pretendimit të paditësit se në pikën 3 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, në rastin e kandidimit të një individi të mbështetur nga zgjedhësit për anëtar të këshillit vendor (bashkiak), nuk aplikohet rregulli i mbështetjes së kandidaturës nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, pasi ky rregull vlen vetëm për kandidatët për kryetar të bashkisë, Kolegji e vlerëson si të pambështetur në ligj. Nga leximi dhe interpretimi në tërësi i dispozitës konkrete, pra nenit 70 të Kodit Zgjedhor, rezulton qartësisht se ky detyrim ekziston edhe në rastin e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish për anëtar të këshillit vendor (bashkiak). Konkretisht në pikën 4 të këtij neni, renditen qartësisht rastet në të cilët kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, përfshirë ata për këshillat vendorë, përjashtohen nga detyrimi i mbështetjes nga 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore (parashikuar në pikën 3). Këto raste janë: - nëse janë kryetarë bashkie; - nëse janë anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse; - nëse janë deputetë. Në këtë rast kandidati duhet të paraqesë një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit. Përsa kohë që paditësi Eduart Nallbani nuk rezulton të përfshihet në asnjërën nga kategoritë e cituara më sipër, ai kishte detyrimin që komiteti nismëtar për mbështetjen e kandidimit të z. Nallbani, të paraqiste në KQZ nënshkrimet mbështetëse të të paktën 7000 (shtatë mijë) zgjedhësve të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë.

**14.** Kolegji konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga Komiteti Nismëtar për regjistrimin e z. Eduard Nallbani si kandidat i pavarur për anëtar të Këshillit Bashkiak Tiranë nuk përmbush kriterin ligjor të vendosur nga neni 70 i Kodit Zgjedhor.

**15.** Kolegji pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoji pretendimet e palëve, vlerëson se padia me paditës Eduard Nallbani duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në prova dhe në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

### **V E N D O S I**

- Rrëzimin e padisë së paditësit Eduart Nallbani.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 18.04.2023.

**GJYQTARE**  
**Manjola XHAXHO**

**GJYQTARE**  
**Edlira PETRI**

**GJYQTARE**  
**Alma KOLGJOKA**

**GJYQTARE**  
**Emona MUÇI**

**GJYQTARE**  
**Marsela DERVISHI**